

VENDIM
Nr.758, datë 16.11.2006

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË SHPËRNDARJES SË FONDIT TË
KOMPENSIMIT NË TË HOLLA, PËR VITIN 2006**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2005 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e subjekteve të shpronësuara, prona e të cilave është e gjitha për kompensim, që nuk kanë përfituar nga kompensime të mëparshme.

2. Përfituesit të jenë sipas radhës së përcaktuar kronologjikisht nga numri i dosjes përkatëse.

3. Vlera e kompensimit të jetë deri për 200 m² të sipërfaqes së përcaktuar për kompensim.

4. Fondi i kompensimit të ndahet në përqindje, sipas nevojave për kompensim, si më poshtë vijon:

a) Për qytetin e Tiranës, 80 për qind ose 240 000 000 lekë;

b) Për rrethin e Kavajës, 20 për qind ose 60 000 000 lekë.

5. Për procedurat të paguhet tarifa prej 2 000 (dy mijë) lekësh.

6. Në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të bëhet dorëzimi i kërkesave për kompensimin në të holla, së bashku me dokumentet e mëposhtme:

a) formularin tip 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, plotësuar nga subjekti;

b) kërkesën e subjektit për kompensim në të holla, për pronën e shtetëzuar, të njohur dhe të përcaktuar për kompensim;

c) vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për njohjen dhe kompensimin e pronës;

ç) dëshminë e trashëgimisë;

d) prokurën e posaçme, të rinovuar dhe të nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të pronës;

dh) fotokopjen e noterizuar të dokumentit të identifikimit (pasaportë, certifikatë ose letërnjoftim) të personit, që ka prokurën e përfaqësimit;

e) mandatpagesën.

7. Agjencia e Kompensimit dhe Kthimit të Pronave të hapë një llogari bankare, me fondin e përcaktuar, prej së cilës të bëhet transferimi, në emër të subjektit përfitues, i vlerave përkatëse të kompensimit në të holla.

8. Ngarkohen Agjencia e Kompensimit dhe Kthimit të Pronave dhe zyra rajonale e Tiranës të ndjekin dhe të realizojnë procesin e kompensimit të pronave në dy zonat e përmendura në pikën 4 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

K E R K E S E

PER FORMEN E KOMPENSIMIT TE PRONES

Drejtuar: Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

Data e paraqitjes së kërkesës: ____/____/2006

Emri / Atësia / Mbiemri i subjektit që paraqet kërkesën ____/____/____
Emri Atësia Mbiemri

Adresa: _____; Tel. / Fax. _____

E-mail: _____

Emri / Atësia / Mbiemri i subjektit të shpronësuar: ____/____/____
Emri Atësia Mbiemri

Kërkesë për formën e kompensimit të pronës (Shëno brenda kuadrateve një ose disa numra, nga 1 (një) deri në 6 (gjashtë) sipas preferencës. Numri 1 tregon preferencën parësore dhe në mënyrë zbritëse numri 6 atë që ju preferoni më pak).

- Me pronë të paluajtshme publike që ndodhet në zona me përparësi zhvillimin e turizmit..... ☐
- Me pronë tjetër të paluajtshme të të njëjtit lloj, me vlerë të barabartë, në pronësi të shtetit.... ☐
- Me pronë tjetër të paluajtshme të çdo lloji, me vlerë të barabartë, në pronësi të shtetit..... ☐
- Me aksione në shoqëri me kapital shtetëror, ose ku shteti është bashkëpronar, që kanë vlerë të barabartë me pronën e paluajtshme..... ☐
- Me vlerën e objekteve, të cilat janë objekt i privatizimit..... ☐
- Me të holla..... ☐

Nënshkrimi i kërkuarit _____